



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **28/2025**

Data: **06 prill, 2025. Ora: 15:00**

Vendi: **KQZ/ Prishtinë**

Në takim ishin të pranishëm: Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi
Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj
Kurtis, Mufera Shinik
U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala
Përkthyes: Jehona Cami
Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Këshillat e KQZ

2.1. Këshilli për Çështje Ligjore

2.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal në Novobërd

3. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari Radoniqi, ka prezantuar rendin e ditës. Ka pasur vetëm një pikë nga Këshilli për Çështje Ligjore. Mbledhja është miratuar, ndërsa është vazhduar me rendin e ditës.

2.Këshillat e KQZ

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal në Novobërd

Sami Hamiti, kryesues i këtij këshilli, e ka paraqitur kërkesën e kuvendit komunal të Novobërdës për zëvendësim të asambleistit. Ai, e ka siguruar KQZ-në se kërkesa është pranuar, dhe se është proceduar më tutje me shqyrtimin e kërkesës. Këshilli, vlerëson se janë plotësuar kushtet edhe sipas rregulloreve, edhe sipas ligjit në përputhje me procedurat e zëvendësimeve, prandaj KCJ i rekomandon KQZ –së që të miratohet ky zëvendësim.

Kreshnik Radoniqi: Sipas kërkesës dhe rekomandimit, z. Nebojsa Arsiq, emërohet anëtar i ri i Kuvendit Komunal në Novobërdë nga subjekti politik “Srpska Lista”, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm të kuvendit komunal, Stefan Kovaceviq. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, e kanë miratuar këtë rekomandim.

3. Të ndryshme !